

*Our Mission:
Supporting improved
educational opportunities for
the children and youth of the
isolated Malësia e Madhe
region of Northern Albania*

President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg
Mary Alice Seville
Nancy Leeper
Kristina Milaj
Mona Jones-Romansic

Albania Manager:

Marash Rakaj



Drita Volaj



Jolanda Mitaj

Edukatoret e Kopshtit, Kelmend

Njihuni me mësueset tona të reja të kopshtit në Kelmendi. AAI ka zgjeruar shtrirjen e saj dhe tani po mbështesim dy kopshte të tjera në rrethin e Malësisë së Madhe. Drita Volaj ka dhënë mësim për 27 vite. Ajo ka lindur në Brojë të Kelmendit në Malësi të Madhe në vitin 1967. Është diplomuar në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës për arsim dhe aktualisht jep mësim në kopshtin e fëmijëve në Shkollën e Përgjithshme “Nike Mernacaj” Tamare.

Jolanda Mitaj, aktualisht jep mësim në shkollën 9-vjeçare të Selcës dhe gjithashtu ka lindur në të njëjtin fshat. Ajo ka përfundua gjimnazin në “Nike Mernacaj” në Tamare dhe ka dhënë mësim në shkollën e Selcës që nga shtatori i vitit 2020. Është e martuar dhe banon në Selcë.

AAI do furnizojë me mjete mësimore këto dy shkolla. Ju urojmë një vit shkollor shumë produktiv dhe të mbarë!

APLIKANTËT PËR BURSË UNIVERSITETORE – 2021-2022

Këtë vit ne mbështesim 7-të nxënës të ri me bursa për universitet. Urime dhe fat të mbarë të gjithë bursistave të AAI!

Joland Pepushaj – Viti i parë, Bachelor, Juridik
Marin Malotaj – Viti i parë, Bachelor, Inxhinieri Ndërtimi
Jurida Shaqiri – Viti i parë, Bachelor, Infermieri/Fizioterapi
Kristjan Pllumaj – Viti i parë, Bachelor, Informatikë
Ernest Ghelaj – Viti i parë, Bachelor, Shkenca Naturore-Matematike
Edona Velaj – Viti i parë, Bachelor, Infermieri
Mikloana Ulaj – Viti i parë, Bachelor, Administrim Biznesi
Mikel Rakaj – Viti i dytë, Bachelor, Administrim Biznesi
Ledi Marinaj – Viti i dytë, Bachelor, Anglisht
Xhesika Bakaj – Viti i tretë, Bachelor, Financë/Kontabilitet
Ermela Celaj – Viti i tretë, Bachelor, Financë/Kontabilitet
Denisa Pepaj – Viti i tretë, Bachelor, Shkenca Naturore-Matematikë
Stela Vulaj – Viti i tretë, Bachelor, Shkenca Naturore-Matematikë
Sentuela Vulaj – Master, Bio-Kimi
Juljana Kuqaj – Master, Financë/Kontabilitet
Gentjan Sterkaj – Master, Administrim Biznesi

Albanian Alps Institute
8600 NW Oak Creek Drive
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285

Email: albanianalpsinst@gmail.com

Website: www.albanianalps.org

NGA PRESIDENTI

Nuk kam qenë në Shqipëri për tre vjet dhe më mungojnë të gjithë miqtë dhe kontaktet e mia atje. Kam në plan të shkoj këtë vit. Megjithatë, AAI vazhdon veprimtarinë e saj. Në vitin 2021, arritëm në një pikë vendimi. Popullsia e nxënësve në shkollat “tona” në Shkrel ka rënë në mënyrë të vazhdueshme që kur udhëtova për herë të parë atje në vitin 1992. Misioni ynë i vetëm është përmirësimi i arsimit në Malsinë e Madhe, në veri të Shqipërisë. A kanë ende nevojë për ne? A kemi ende një rol për të luajtur? Pasi e diskutuam këtë me Përfaqësuesin Shqiptar Marash Rakaj dhe Bordin e Drejtorëve të AAI-t, vendosëm që, po, ne ende plotësojmë një vend në arsimin verior të Shqipërisë dhe mënyra më e mirë për të ecur përpara është të rrisim zonën tonë gjeografike të veprimit.

Ekziston një tjetër komune rurale, edhe më e izoluar, në veri të Shkrelit. Rrethi shkollor i Kelmendit, kryesisht në Luginën e Cemit, ka shkolla fillore (1-9), në Vukel, Selcë dhe Vermosh dhe një shkollë dymbëdhjetëvjeçare në Tamarë. Në Tamare dhe Selcë ka kopshte. Unë kontaktova me drejtorin e shkollës Kelmend për të ofruar mbështetjen e AAI-t për bursa universitare, libra për bibliotekat e tyre dhe mjete mësimore për kopshtin. Ajo ishte shumë mikpritëse të bashkpunoj me ne. Unë e njoh mirë Luginën e Cemit, pasi kam vizituar për herë të parë atje në vitin 2005, dhe jam i emocionuar që kam një arsye për të shkuar atje më shpesh, duke vizituar shkollat dhe mësuesit. Është një zonë e bukur.

Në lajme të tjera, kemi më shumë studentë universiteti që marrin bursa se kurrë më parë, kryesisht në Universitetin e Shkodrës, por dy në Universitetin e Tiranës dhe një në një shkollë private biznesi. J'u urojmë mbarësi. Si gjithmonë, programet tona shkojnë përpara vetëm falë donatorëve tanë bujarë. Jam i kënaqur që kemi filluar të marrim donacione nga ish-studentë dhe shqiptarë të emigrantëve që jetojnë në SHBA, duke treguar një besim në atë që bëjmë. Dhe sigurisht, një falënderim i madh për donatorët tanë kryesorë në SHBA, ne vazhdojmë t'i bëjmë donacionet tuaja të arrijnë programet "në terren" pasi AAI ka shumë pak shpenzime administrative.



Klasa e Anglises në Bogë (majtas) dhe Vrith (djathtas)

amazonsmile
Org Central

Amazon Smile është një mënyrë e thjeshtë dhe automatike për të mbështetur organizaten tuaj të preferuar bamirëse, pa ju kushtuar juve asnjë lek. Kur blini në smile.amazon.com, ju do gjeni ekzaksisht të njëjtat produkte dhe çmime si në Amazon.com, por me bonus, sepse Amazon do të dhuroj 0.5% të çmimit të artikujve që ju blini për organizaten tuaj të preferuar.

Herën e parë që shkoni në smile.amazon.com, hyni një lloj si tek Amazon.com. Atëherë përzgjidhni organizaten bamirëse që ju dëshironi të mbështesni (shpresoj që të jemi ne). Amazon e mban mend zgjedhjen tuaj dhe c'do blerje e juaja nëpërmjet smile.amazon.com rezulton në një donacion nga Amazon për organizata që ju zgjedhët. Vetëm mbaj mend të shkoni në smile.amazon.com, hyr si zakonisht dhe vazhdoni blerjen!